

VENDIM
Nr. 293, datë 14.5.2014

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 53, DATË 21.1.2009, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR NGARKIMIN E MINISTRISË SË BRENDSHME PËR KRYERJEN E PROCEDURAVE TË
PROKURIMIT PUBLIK, NË EMËR DHE PËR LLOGARI TË KRYEMINISTRISË, MINISTRIVE
DHE INSTITUCIONEVE TË VARËSISË, PËR DISA MALLRA E SHËRBIME”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 11 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe të shkronjës “b” të pikës 2 të vendimit nr. 1, datë 10.1.2007, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në fund të pikës 1 të vendimit nr. 53, datë 21.1.2009 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Përgjashtimisht për vitin 2014, lejohet Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, si autoritet kontraktor, të realizojë vetë procedurat e prokurimit për:

a) blerje uniformash, veshmbathjesh dhe elementesh të tjera përbërëse të tyre;

b) blerje këpucësh.”.

2. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama